



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401214/5

Tiranë ___/___/2015

Lënda : *Marrjen e masave për lëshimin e dokumentave të pronësisë shtetasit T.M. etj, për pasurinë e regjistruar me nr.143, datë 21.02.2005 të rregjistrimit hipotekor.*

Drejtuar : **Rregjistruarit të Zyrës Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme,**

FIER

Për dijeni : **Ministrisë së Drejtësisë**

Kryeregjistruarit të Zyrës Qendrore të Rregjistrimit të pasurive të Paluajtshme
Z.Illirjan Muho

T.M.
Adresa:

FIER

Z.Rregjistruarit!

Në procesin e shqyrtimit të ankesës së shtetasit T.M., ju është kërkuar me shkresën nr. K3/T12-2 Prot, datë 14.08.2014, dhënia e shpjegimeve lidhur me shkaqet të cilat justifikojnë moslëshimin e dokumenteve të pronësisë shtetasit T.M., për pasurinë e regjistruar në bashkëpronësi të tij me nr.143, datë 21.02.1995, të rregjistrimit hipotekor, me rastin e kryerjes nga ana e tij të aplikimit nr.113, datë 06.03.2012 dhe nr.159, datë 12.06.2012, në afatin e përcaktuar në K.Pr.Administrative si dhe shkaqet që justifikojnë moslëshimin e aktit të pronësisë për sipërfaqen e truallit prej 310 m2 të transkriptuar në favor të tij, sipas notës së transkriptimit datë 24.VII.1965, lëshuar nga nëpunësi i Hipotekës, Tiranë, z. Leon Thomo.

Në përgjigje të kërkesës nr. K3/T12-2 Prot, datë 14.08.2014, të Avokatit të Popullit, ju me Tuajën nr.4174/1 Prot, datë 22.08.2014, jepni informacion i cili vërteton moskryerjen në mënyrë të rregullt të veprimeve për lëshimin e dokumentave të pronësisë në favor të ankuesit T.M.

Referuar akteve të vëna në dispozicion prej ankuesit si dhe organit që ju përfaqësoni, rezulton se :

Shtetasi T.M. si dhe trashëgimtarët e tjerë të të ndjerit K.M., sipas Vendimit nr. 152, datë 09.12.1994, të Komitetit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Ish-pronarëve, Bashkia, Fier, ju është njohur në pronësi me të drejtë kthimi në natyrë sipërfaqja e truallit prej 1780 m² e ndodhur në Lagjen “16 Prilli”, Fier. Regjistrimi i titullit të pronësisë, Vendimit Nr. 152, datë 09.12.1994, të Komitetit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Ish-pronarëve, Bashkia, Fier, është kryer konform nenit 193 të Kodit Civil, si dhe ligjit nr.7843, datë 13.07.1994, “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” pranë Zyrës së Hipotekës, sot Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Fier. Transkriptimi në pronësi të trashëgimtarëve të të ndjerit K.M., i sipërfaqes së truallit prej 1780 m², njohur e kthyer në natyrë sipas Vendimit nr. 152, datë 09.12.1994, të KKKP Ish-pronarëve, Bashkia, Fier, është kryer më datë 21.02.1995, rregjistri i pronësisë private nr.143, (indeksi) 23/m etj.

Zyra e Hipotekës, sot Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Fier, më datë 21.02.1995, ka lëshuar në favor të T.M., etj, notën e traskriptimit e cila vërteton rregjistrimin në bashkëpronësi të sipërfaqes së truallit prej 1780 m², mbi të cilën ndodhen dhe banesat e tyre.

Refruar deklarimeve në Tuajën nr.4174/1 Prot, datë 22.08.2014, si dhe akteve të vëna në dispozicion bashkëlidhur kësaj shkrese, kuptohet se, veprimtaria e kryer prej organit që ju përfaqësoni në trajtimin e aplikimit të ankuesit T.M., nuk është kryer në përputhje me parashikimet e nenit 25/a të ligjit nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Në mënyrë të pajustificueshme, ZVRPP, Fier, e ka trajtuar rastin e regjistrimit të Vendimit nr. 152, datë 09.12.1994, të KKKP Ish-pronarëve, Bashkia, Fier, si titull pronësie i cili nuk ka të përcaktuar sipërfaqen. Bashkëlidhur Vendimit nr. 152, datë 09.12.1994, të KKKP Ish-pronarëve, Bashkia, Fier, si pjesë përbërëse e këtij vendimi është plan vendosja e cila përcakton vendndodhjen e pasurisë, truall me sipërfaqe 1780 m², të njohur në pronësi me të drejtë kthimi në natyrë trashëgimtarëve të të ndjerit K.M.. Edhe pse pronësia dhe kufijtë e pasurisë së paluajtshme përcaktohen në aktin e fitimit të pronësisë, ZVRPP, Fier, nuk ka respektuar parashikimin e kryer në nenin 25/a të Ligjit Nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, duke zhvilluar me këtë rast një veprimtari në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë dhe atë të përgjegjshmërisë, sikurse parashikuar në nenin 9 dhe 14 të K.Pr.A., të detyrueshme për zbatim në kuptim dhe zbatim të nenit 1 të këtij Kodi. Pa shkak, ZVRPP, Fier, ka proceduar për regjistrimin e pasurisë në bashkëpronësi të ankuesit T.M., referuar pikës “b” të nenit 25 të Ligjit Nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ndërkohë që dokumentacioni i pronësisë së z.M etj, ka të përcaktuar sipërfaqen e pasurisë së paluajtshme.

Me tej, në Tuajën Nr. nr.4174/1 Prot, datë 22.08.2014, bëni të ditur, se; Zona Kadastrale nr.8534, ku dhe ndodhet pasuria në bashkëpronësi e ankuesit, i është nënshtruar procesit të regjistrimit fillestar të pasurive dhe se pasuria në bashkëpronësi e ankuesit është rregjistruar me nr.7/9, Vol 11, Faqe 156. Referuar kartelës të pasurisë së paluajtshme nr. 7/9, Vol 11, Faqe 156, rregjistrimi i pasurisë në favor të ankuesit etj, është kryer më datë 27.01.2013, dhe që prej kësaj date, kjo kartel nuk i është vënë në dispozicion ankuesit. Gjithashtu, nga ana juaj, pranohet se, ankuesi ka dorëzuar pranë ZVRPP, Fier, plan rilevimin për pasurinë e tij në bashkëpronësi si dhe gjithë aktet e administruara në

çështjen gjyqësore për të cilën Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier, është shprehur me Vendimin nr. 460, datë 08.04.2002, për njohjen e z.K.M. dhe K.M. bashkëpronar në ½ pjesë mbi sipërfaqen e truallit prej 1780 m² të njohur dhe kthyer në natyrë sipas Vendimit nr. 152, datë 09.12.1994, të KKKP Ish-pronarëve, Bashkia, Fier. Referuar akteve të ndodhura në dosjen gjyqësore, ju shpreheni se keni konstatuar, se, Vendimi nr. 152, datë 09.12.1994, i KKKP Ish-pronarëve, Bashkia, Fier, është kopje e njehsuar me origjinalin nga ana e noterit dhe për këtë shkak keni vendosur masën e kufizimit në seksionin “E” të kartelës së pasurisë të paluajtshme. Akti (Urdhëri) sipas të cilit ju shpreheni se keni vendosur masën e kufizimit mbi pasurinë në bashkëpronësi të ankuesit nuk është vënë në dispozicion të Avokatit të Popullit dhe as përmenden ekstremitetet e tij në kartelën e pasurisë të paluajtshme apo shkresën nr. nr.4174/1 Prot, datë 22.08.2014, që keni dërguar.

Fakti që pasuria e paluajtshme në bashkëpronësi e ankuesit është regjistruar qysh më datë 27.01.2013, vërteton se ju dispononi titullin e pronësisë për pasurinë nr.7/9, Vol 11, Faqe 156, qoftë original apo i vërtetuar me origjinalin tek noteri. Qëndrimi i shprehur nga ana juaj se keni vendosur masën e kufizimit në seksionin “E” të kartelës së pasurisë të paluajtshme për shkak të konstatimit se në dosjen gjyqësore, Vendimi nr. 152, datë 09.12.1994, i KKKP Ish-pronarëve, Bashkia, Fier, është kopje e njehsuar me origjinalin nga ana e noterit, është shprehje e paditurisë lidhur me vlefshmërinë e akteve. Referuar nenit 39/f të ligjit nr.7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar, noteri ka kompetencë midisë të tjerave të vërtetojë se kopjet ose shkurtimeve e dokumenteve janë të njëjta me origjinalin e paraqitur nga të interesuarit. Në këtë situatë ligjore nuk ka pasur dhe nuk ka shkak për justifikimin e vendosjes së masës së kufizimit sikurse shprehur në shkresën nr. 4174/1 Prot, datë 22.08.2014, drejtuar Avokatit të Popullit. Veprimtaria e derisotme e kryer prej ZVRPP, Fier, për dhënien e shërbimit të kërkuar prej ankuesit në mënyrë të ripërsëritur më datë 06.03.2012 dhe 12.06.2012, është në çënim të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor sikurse sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë apo nenin 6/1 të Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, miratuar me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, prej Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, duhet kuptuar se veprimtaria e kryer prej punonjësve të organit që ju përfaqësoni, në rastin e prezantuar, është kryer në kundërshtim me parimin e sanksionuar në nenin 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 1 “Mrojtja e pronës”, Protokollin nr.1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, miratuar me Ligjin nr. 31.07.1996, prej Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për ratifikimin e Konvetës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin thuhet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenit 21/b, se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”.

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave për lëshimin e dokumentave të pronësisë shtetasit T.M. etj, për pasurinë e regjistruar me nr.143, datë 21.02.2005 të rregjistrit hipotekor apo sot me nr. 7/9, Vol 11, Faqe 15, të regjistrit të ZVRPP, Fier.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Etilda GJONAJ(SALIU)

**Konceptoi dhe Daktilografoi
A.Gjoleka**